



TË DREJTAT BAZË TË NJERIUT PËR TË BURGOSURIT QË JANË SHTETAS TË HUAJ (FNPs)

Informacioni

1. E drejta për të marrë në momentin e arrestimit dhe në fillim të ndalimit ose burgimit, ose menjëherë pas këtij momenti, informacion në një gjuhë në të cilën i kupton të drejtat e tij dhe se si mund t'i përdorë këto të drejta. (UN Principles 13-14, CoE Police 55)
2. E drejta për t'u informuar për arsyet e arrestimit dhe aktakuzave në një gjuhë që i burgosuri mund të kuptojë. (ICCPR 14.3, UN Principles 10, EU2012 6)
3. E drejta për të informuar një person që zgjidhet nga ai vetë rreth ndalimit. (UN Principle 16.1, CoE FNP 15.2, CoE Police 57, EU2012 4.2 c)
4. E drejta për të marrë informacion rreth rregullave të burgut dhe të drejtave e detyrave të të burgosurve në një gjuhë që mund të kuptohet nga i burgosuri. (UN Rec 4, SMR 54-55, EPR 30.1, CoE FNP 15.1)
5. E drejta për t'u informuar rreth të gjërave që i takojnë, për të kontaktuar autoritetet konsullore dhe për të marrë vizita dhe ndihmë konsullore. (VCCR 36.1 b-c UN Principles 16.2, UN Res (e), UN Rec 4, SMR 62, CAT 6.3, EU Charter 46, EPR 37.1, CoE FNP 24)
6. E drejta për t'u informuar rreth mundësive të transferimit në shtetin e origjinës. (EPR 37.5, CoE FNP 15.3, CoE Transfer 4.1, EU909JHA 6.4)

Gjyqi i drejtë

7. E drejta për një ndreqje të efektshme dhe një gjyq të drejtë. Të gjithë atyre që ju është ngritur aktakuzë do të supozohen të pafajshëm derisa të provohet se janë fajtorë sipas ligjit; (ICCPR 14, UDHR10-11.1, ECHR 6, EU Charter 46-47)
8. E drejta për të marrë ndihmë ligjore në procedimet penale. (ICCPR 14.3 d, SMR 61, UN Principles 17-18, EPR 23, CoE FNP 21)
9. E drejta për të marrë ndihmë falas nga një përkthyes kur i burgosuri nuk mund të kuptojë ose të flasë gjuhën e përdorur në gjykatë. (ICCPR 14.3 f, UN Principles 14, UN Res (c))
10. E drejta për të qenë i barabartë përpara gjykatës dhe për t'u gjykuar pa vonesa të panevojshme. (ICCPR 14.1, 14.3 c)
11. E drejta për t'u liruar në pritje të gjyqit, përveçse kur autoriteti gjyqësor ose një autoritet tjetër vendos ndryshe në interes të administrimit të drejtësisë. (UN Principle 39, CoE FNP 5)
12. E drejta për t'u konsideruar për të njëjtat sanksione dhe masa që nuk kërkojnë burgim sikurse të burgosurit e tjerë. (UN Rec 2, UN Res (d), CoE FNP 4, 14.1)
13. E drejta që të mos jenë subjekt i dënimeve më të rënda me burg ose kushteve më të rënda të burgimit thjeshtë për shkak se janë shtetas të huaj. (UN Res (b))
14. E drejta për t'u kualifikuar plotësisht për lirim të mëhershëm. (CoE FNP 6)

Trajtimi

15. E drejta për t'u trajtuar me humanizëm dhe respekt për dinjitetin e pandarë të

njerëzve. (ICCPR 10.1, UDHR 5, SMR 1, CAT 1-2, UN Basic Principles 1, ECHR 3, EU Charter 4, EPR 1)

16. E drejta për t'u mbrojtur nga tortura ose trajtimi apo ndëshkimi çnjerëzor ose degradues; (ICCPR 7, UDHR 5, CAT 7, ECHR 3, EU Charter 4)
17. E drejta për t'u trajtuar në mënyrë të tillë që të merren në konsideratë situatat dhe nevojat individuale të të burgosurve që janë shtetas të huaj. (CoE FNP 3)
18. E drejta për të mos u diskriminuar (përfshi arsyet e tilla si origjina kombëtare dhe gjuha) dhe për të marrë mbrojtje të efektshme ndaj diskriminimit. (ICCPR 26, UDHR 7, SMR 2, UN Principles 5, UN Basic Principle 2, EU Charter 21-22, EPR 13, CoE FNP 7)
19. E drejta për të pasur akses te i njëjti kujdes shëndetësor dhe programet e trajtimit që janë në dispozicion për të burgosurit e tjerë. (EU Charter 35, CoE FNP 31)
20. E drejta për lirinë e mendimit, vetëdijes dhe besimit dhe liria për ta manifestuar këtë në adhurim dhe respektim. (ICCPR 18.1, UDHR 18, SMR 65-66, UN Basic Principles 3, UN Rec 3, EU Charter 10.1, EPR 29, CoE FNP 30)
21. E drejta për të veshur rroba dhe ruajtur higjienën personale në mënyrë të tillë që të mos ofendojë ndjeshmëritë kulturore dhe fetare të të burgosurve dhe për të marrë ushqim që merr parasysh kërkesat kulturore dhe fetare. (UN Rec 4, CoE FNP 18,19)
22. E drejta për të mos pasur ndërhyrje në privatësinë, jetën familjare dhe korrespondencën dhe për të marrë kontakt (edhe nëpërmjet vizitave) me familjen dhe miqtë rregullisht. (ICCPR 17, UDHR 12, SMR 58, UN Rec 5, EU Charter 7, EPR 24, CoE FNP 22)
23. E drejta për të pasur akses te përkthimi me shkrim dhe gojë në burg dhe mundësisht për të mësuar një gjuhë për të lehtësuar komunikimin. (SMR 61.2, EPR 38.3, CoE FNP 8, 29.1)
24. E drejta për të pasur të njëjtin akses sikurse të burgosurit vendas në edukim, punë dhe trajtim profesional. (UN Rec 1, SMR 4.2, 71, EPR 26, 28, CoE FNP 27.1, 29)
25. E drejta për të bërë pa censurë një kërkesë ose ankesë tek administrata qendrore e burgut, autoriteti gjyqësor ose autoritetet e tjera të duhura nëpërmjet mënyrave të miratuara. (SMR 56, UN Rec 4, EPR 70)

Rivendosja

26. E drejta për të marrë trajtimin që synon reformimin dhe rehabilitimin social për t'u përgatitur për lirinë në shoqëri. (ICCPR 10.3, SMR 4, EPR 6, 107, CoE FNP 9, 29.2, 35)
27. E drejta për t'u informuar sa më parë rreth statusit të tyre ligjor dhe situatës pas lirit. (CoE FNP 35.2 a)
28. E drejta për t'u mbrojtur nga përjashtimi, kthimi ose ekstradimi në një shtet ku ka një rrezik serioz se do të ndëshkoheni me vdekje, torture ose trajtim apo ndëshkim tjetër çnjerëzor ose degradues; (UDHR 14, CAT 3, EU Charter 19.2)
29. E drejta që miratimi dhe rintegrimi social i të burgosurve të merret parasysh në vendimin për transferimin në një shtet tjetër. (UN Transfer 1, CoE Transfer 4, CoE FNP 10)
30. E drejta për të krijuar marrëdhënie me agjencitë jashtë burgut për të marrë ndihmë dhe mbështetje me rivendosjen pas lirit. (SMR 107-108, 81, EPR 107, CoE FNP 37, CoE Probation 64)

Kombet e Bashkuara

- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (UDHR)
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR)
- Komventa e OKB-së për Torturën (CAT)

- Rregullat Standarde Minimale për Trajtimin e të Burgosurve (SMR Mandela Rules)
- Konventa e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore (VCCR)
- Marrëveshja Model për Transferimin e të Burgosurve të Huaj (UN Transfer)
- Parimet Bazë të Kombeve të Bashkuara për Trajtimin e të Burgosurve (UN Basic Principles)
- Tërësia e Parimeve të KB-së për Mbrojtjen e Gjithë Personave nën çdo Formë Ndalimi ose Burgimi (UN Principles)
- Rekomandimet për Trajtimin e të Burgosurve të Huaj (UN Rec)
- Rezoluta e KB-së 1998/22 Statusi i shtetasve të huaj në procedimet penale (UN Res)

Këshilli i Evropës

- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (ECHR)
- Rregullat Evropiane për Burgjet (EPR)
- Rekomandimi (2012)12 në lidhje me të burgosurit e huaj (CoE FNP)
- Konventa për Transferimin e Personave të Burgosur (CoE Transfer)
- Rekomandimet CM/Rek (2010)1 Rregullat e Lirimit me Kusht (CoE Probation)
- Rekomandimet Rek (2001)10 Kodi Evropian i Etikës së Policisë (CoE Politics)

Bashkimi Evropian

- Karta e të Drejtave të Njeriut e Bashkimit Evropian (EU Charter)
- Vendimi Kuadër i Këshillit 2008/909/JHA (EU909JHA)
- Direktiva 2010/64 për të drejtën e përkthimit me gojë e shkrim në procedimet penale (EU2010)
- Direktiva 2012/13 për të drejtën e informacionit në procedimet penale (EU2012)